

**PYETJE TË SHPESHTA MBI THIRRJEN PUBLIKE NR.II PËR
PROJEKTPROPOZIME, DREJTUAR NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE.**

- 1- Sa është shuma e financimit për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore për Thirrjen Nr. 2?
Shuma e financimit nga AKR-ja është fikse 10.000.000 (dhjetë million lekë), por duhet që vet NJVV-të të parashikojnë financimin prej të paktën 10% mbi shumën e kërkuar nga AKR-ja.
- 2- A mundet të ketë financime të tjera nga donatorë për këtë projekt?
Po, NJVV-të mund të kërkojnë burime të tjera financimi për projektpropozimin e tyre.
- 3- A mundet NJVV-ja të bashkëpunojë me një Organizatë për zbatimin e projektit?
Po, është e lejuar që të bashkëpunojë NJVV-ja me Organizata të tjera, por duke mbajtur parasysh që AKR-ja financon vetëm infrastrukturë rinore jo aktivitete që mund të realizojë Organizata.